




**PASAPORTA
E STABILIZIM ASOCIMIT**



Qendra Europiane

PASAPORTA E STABILIZIM-ASOCIMIT

Projekti i realizuar në kuadrin e



Mbështetur nga






Procesi i Stabilizim Asocimit është një platformë e gjerë marrëdhëniesh që konsiston në një sërë instrumentesh me karakter të ndryshëm si politik, institucional, ligjor, ekonomik, tregtar, financiar, burimesh njerëzore, social, etj. Ai përbën platformën themelore të marrëdhënieve mes BE-së dhe Shqipërisë.



Procesi i Stabilizim Asocimit ka për objektiv përfundimtar përgatitjen e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE, si një vend anëtar me merita dhe të drejta të plota dhe që të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha standardet që lindin nga ky anëtarësim, si ndaj qytetarëve të saj, ashtu edhe ndaj qytetarëve apo strukturave europiane.



Për arritjen e objektivit të anëtarësimit, Shqipëria bëhet palë në një marrëdhënie asocimi të krijuar nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. Kjo marrëdhënie asocimi ka si qëllim ecjen e Shqipërisë përpara në rrugën e shtetit të së drejtës, të demokracisë, stabilitetit institucional dhe politik, rregullave që ofrojnë të njëjtat përfitime si ato brenda BE-së dhe të shndërrimin nga ekonomi tranzicioni në ekonomi funksionale tregu.



Qeverisja e aspekteve kryesore të jetës së shoqërisë shqiptare dhe të shtetit shqiptar dhe politikat kryesore do të hartohen dhe zbatohen në partneritet me BE-në.



Reformat dhe proceset politike shqiptare do të diskutohen me partnerët europeanë në nivel qeveritar, parlamentar dhe teknik për ta bërë procesin e bashkëpunimit sa më të gjerë. Shoqëria civile do të ketë gjithashtu vendin e vet në këtë proces bashkëpunimi. Brenda këtij kuadri, struktura të posaçme BE-Shqipëri do të kontrollojnë zbatimin respektiv të MSA-së.



MSA-ja krijon kushtet për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore nga autoritetet shqiptare. Koncepti shqiptar i këtyre lirive dhe të drejtave duhet të jetë i njëjtë me atë europian. Por, respektimi i këtyre të drejtave dhe lirive përbën një kusht përcaktues për zbatimin e MSA-së dhe vazhdimin e marrëdhënies së asocimit. Në rast të kundërt, MSA-ja mund të pezullohet ose të ndërpritet.



Autoritetet shqiptare, për zbatimin e MSA-së, do të punojnë bashkë me strukturat e BE-së. Në këtë mënyrë strukturat e shtetit shqiptar duhet të aftësohen të veprojnë sipas mënyrës dhe ritmit të punës së institucioneve të BE-së dhe të atyre të shteteve anëtare.



Institucionet shqiptare, në këtë proces angazhimesh të mëdha, ndihmohen nga një mbështetje financiare e BE-së që quhet CARDS (*Ndihma Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilitet*), e cila drejtohet aty ku janë nevojat më specifike të shtetit dhe shoqërisë shqiptare.

Institucionet shqiptare, publike dhe private, mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në programe dhe projekte që hapen nga BE-ja në Bruksel, duke thithur fonde dhe duke realizuar aktivitete në shërbim të procesit të integritimit.



Republika e Shqipërisë, në kuadrin e Procesit të Stabilizim Asocimit, duhet të ndjekë një politikë të jashtme të njëjtë me atë të Bashkimit European. Kjo është një mënyrë për të pasur një aleat të madh në çështjet e politikës ndërkombëtare.



Bashkëpunimi rajonal që MSA-ja parashikon, krijon mundësitë konkrete që Ballkani të shndërrohet në një rajon ku konfliktet ndërmjet fqinjëve do të jenë pjesë e historisë gjithnjë e më të largët. Ky rajon do të orientohet i tëri drejt stabilitetit dhe prosperitetit dhe vetëm si i tillë do ketë mundësi të përfshihet në strukturat europiane.



Mallrat e prodhuara në Shqipëri mund të futen në tregun e BE-së pa paguar doganë dhe pa u kufizuar në sasi. Në këtë mënyrë, një tregtar, shqiptar apo i huaj, mund të fusë në tregun europian aq mallra të prodhuara në Shqipëri sa ka mundësi të shesë në tregun europian dhe nuk duhet të paguajë doganë për to, me përjashtim të disa produkteve si lloje të peshkut, të verërave dhe pijeve alkoolike...



Gradualisht, edhe mallrat europiane do futen gjithashtu pa doganë dhe pa kufizim në tregun shqiptar.

Produktet shqiptare dhe ato europiane do të taksohen njësoj si në Shqipëri, ashtu edhe në vendet anëtare të BE-së, pa pësuar asnjë diskriminim.

...

Kjo do të thotë që konsumatori shqiptar do të gjejë në treg produkte me cilësi më të mirë, me çmim më të ulët dhe që tregtarët shqiptarë që importojnë mall nga jashtë nuk do të paguajnë më dogana apo të kufizohen në sasi për mallin që sjellin.

...

Por kjo mund të çojë në daljen nga tregu ose uljen e shitjeve të mallrave të caktuara shqiptare nga konkurrenca e mallrave europiane.



Që mallrat shqiptare të mund të përfitojnë nga hapja e tregut europian duhet që ato të respektojnë rregullat e origjinës – d.m.th. të vërtetohet se janë prodhuar ose përpunuar në një masë të duhur në Shqipëri. Këtë lëshim tregtar me anë të MSA-së Bashkimi Europian ia bën Shqipërisë vetëm për mallrat me origjinë shqiptare dhe jo edhe për ato që vijnë nga vende të treta të cilat nuk e përfitojnë këtë lëshim.



Në qoftë se produktet shqiptare nuk respektojnë standardet e prodhimit dhe të tregtimit dhe nuk certifikohen sipas normave europiane, nuk do të mund të tregtohen as në tregun shqiptar, as në atë europian. E njëjta gjë ndodh edhe me tregtinë brenda vendeve anëtare – në qoftë se një mall i prodhuar në një vend anëtar nuk respekton normat europiane, kur ka të tilla, atëherë ai mall nuk përfiton nga tregtia e lirë.



Për ta ndihmuar ekonominë shqiptare që të arrijë standardet europiane, BE-ja i trajton në mënyrë të privilegjuar mallrat shqiptare dhe ky privilegj do të vazhdojë gjatë një periudhe dhjetë vjeçare. Pas kësaj periudhe, mallrat shqiptare dhe ato europiane do të trajtohen njësoj në tregtinë ndërmjet palëve (BE – Shqipëri).

Shqipëria, për të mbrojtur sektorë të veçantë të ekonomisë kombëtare, mund t'i mbrojë disa produkte – të quajtura “të ndjeshme” – duke mbajtur në fuqi kufizime ose doganë ndaj produkteve të ngjashme që vijnë nga BE-ja.



Që ekonomia shqiptare të mund të mbijetojë në kushtet e krijimit të këtij tregu të lirë me BE-në duhet të bëhet më konkurruese dhe duhet t'u përshtatet jo vetëm nevojave dhe shijeve të konsumatorit shqiptar, por edhe të atij rajonal dhe europian.



Në qoftë se nga tregtimi i lirë i produkteve të caktuara preket siguria publike, rendi publik, shëndeti publik, dhe koncepte të ngjashme, një numër i madh prodhuesish, ose një sektor i gjerë ekonomik, qoftë Shqipëria, qoftë BE-ja mund të vendosin masa kufizuese specifike.

Kjo nënkupton që doganat dhe autoritetet përkatëse shqiptare të kontrollit duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë se sa çdo produkt, i prodhuar në Shqipëri ose në BE respekton konceptet e mësipërm.



Kur punëtorët shqiptarë janë të punësuar në një vend anëtar të Bashkimit European, në bazë të MSA-së, nuk mund të diskriminohen për arsye të shtetësisë në lidhje me kushtet e punës, pagën, ose largimin nga puna. Madje ata mund të marrin me vete edhe pjesëtarët e familjes të cilët mund të punësohen në mënyrë të ligjshme në atë vend dhe të arsimohen gjatë periudhës së qëndrimit të ligjshëm në një vend anëtar.

Por shtetasit shqiptarë nuk mund të punësohen në sektorin publik të vendeve anëtare të BE-së dhe as qytetarët europianë nuk mund të punësohen në sektorin publik shqiptar.



Për ta bërë sa më efektive të drejtën e punësimit në vendet anëtare të BE-së për shqiptarët dhe për të rritur numrin e punëtorëve shqiptarë në tregun europian duhen përfunduar marrëveshje bilaterale punësimi ndërmjet Shqipërisë dhe secilit prej vendeve anëtare të BE-së.



Pas një periudhe kalimtare të zbatimit të MSA-së, një person fizik shqiptar do të mund të ushtrojë veprimtarinë e tij tregtare në çdo vend anëtar të BE-së dhe anasjelltas, një person fizik nga BE-ja në Shqipëri.


Personat juridikë (si p.sh. shoqëritë tregtare) shqiptarë dhe europianë do të mund të nisin aktivitete tregtare ose të hapin filiale, degë ose përfaqësi në territoret e njëri-tjetrit në të njëjtat kushte me personat juridikë vendas.

Zbatimi i MSA-së do të lejojë që subjektet shqiptare dhe të BE-së, fizikë ose juridikë, të ofrojnë shërbime në të njëjtat kushte duke lëvizur në territoret e njëri-tjetrit, ose edhe pa lëvizur nga vendi i tyre.





Lëvizja e parave për qëllime pagesash dhe investimesh nga Shqipëria drejt BE-së dhe anasjelltas do të liberalizohet dhe gradualisht nuk do të ketë as kufizime në sasi as interesa për t'u paguar.




MSA-ja do të ndihmojë në rritjen e konkurrencës dhe eliminimin e monopoleve – gjë që do të thotë produkte dhe shërbime më të mira dhe më të lira për shqiptarët.



MSA-ja do të ndihmojë që gradualisht ligjet shqiptare të përngjasojnë me ato të BE-së.

Administrata dhe gjyqësori shqiptar do të bëhen gradualisht të aftë të zbatojnë dhe të interpretojnë të drejtën e Bashkimit Europian, dhe do iu duhet të garantojnë zbatimin e ligjit në një nivel të ngjashëm me atë europian, sidomos përsa i përket rendit, krimin të organizuar, trafikëve, korrupsionit, ligjeve tregtare dhe fiskale, pronës, zbatimit të vendimeve gjyqësore.



Organet e BE-së nuk mund të nxjerrin akte që bien në kundërshtim me angazhimin e tyre ndaj Shqipërisë dhe interesave të qytetarëve shqiptarë në kuadrin e MSA-së.

Secili prej 25 Shteteve Anëtare të BE-së, është i detyruar që të respektojë angazhimet ndaj Shqipërisë në kuadrin e MSA-së dhe të mos bëjë asnjë veprim që bie në kundërshtim me këto angazhime.

As organet e shtetit shqiptar nuk mund të nxjerrin asnjë ligj apo akt që të bjerë në kundërshtim me angazhimet në kuadër të MSA-së.

Botim i Qendrës Europiane

Design and Layout Grafika “Elzana” 

Vizatimet Adnan Kastrati

Shtypur në Shtypshkronjën “albPAPER”